

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Mbështetja e Potencialit Turistik të Korishës
Instrumenti:	Grante të vogla për projek
Subjekti zbatues:	OJQ MONUMENTA
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Rexhep Luci, H1 nr:8, Prishtinë ojqmonumenta@gmail.com +383 44 921 670
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/04/2025 Data e përfundimit: 31/12/2025
Buxheti total i grantit (EUR):	EUR 10,000.00
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	EUR 10,000.00
Grupet e synuara:	Rinia
Shtrirja gjeografike:	Fshati Korishë, Komuna e Prizrenit
Përmbledhje e grantit:	Qëllimi kryesor i këtij projekti është mobilizimi i komunitetit lokal për të ndërtuar një vizion të përbashkët dhe afatgjatë për zhvillimin e fshatit Korishë si atraksion turistik. Përmes takimeve të rregullta me komunitetin dhe fokus-grupeve me të rinjtë, synohet forcimi i ndjenjës së përgjegjësisë lokale dhe të nxitja e pjesëmarrjes aktive në planifikimin e së ardhmes së zonës. Është diskutuar vizioni për zhvillimin e fshatit dhe zonës përreth deri në Kabash, duke i dhënë përparësi ruajtjes së trashëgimisë dhe përdorimit të qëndrueshëm të resurseve ekzistuese. Turizmi shërben si një mjet për nxitjen e zhvillimit lokal. Projekti përfshin trajnime për të ofruar akomodim, ushqim tradicional dhe aktivitete rekreative, si dhe promovimin e shtigjeve të ecjes dhe pikave të interesit si ujëvarat, malet, fortifikata ilire dhe Kisha e Shën Pjetrit. Një publikim tashmë i realizuar, "Ecje nëpër Kabash", prezanton 10 pika kyçe të interesit, ndërsa "Oferta turistike e Korishës" do të jetë botimi i ardhshëm që do të strukturojë mundësitë ekzistuese.

Bashkëfinancuar nga:



	Gjithashtu, janë identifikuar aktorët lokalë, si klubet e sporteve dhe shoqëritë kulturore, me të cilët është diskutuar strukturimi i një oferte gjithëpërfshirëse. Të gjitha aktivitetet e projektit do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me banorët, duke pasur parasysh rëndësinë e përfshirjes së tyre për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të pavarur.
--	---